



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-

01.Nr. zyrtar/ 2019



Komuna e Kaçanikut

Procesverbal

Takimi i VI-të dhe i fundit i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019

Më 24.12.2019

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Jaser Jaha, zv.Komandant i Policisë-Kaçanik

Lulzim Uka, përfaqësues i FSK-së

Kjani Sallahu, FOJK

Fatmir Qaka, EVSB

Shemsedin Abazi-KLSP

Ramadush Osmani-Drejtësor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencia

Lirije Luta- Komiteti për Komunitete

Zahir Doda-Drejtësor i DAK

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërvëve

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Kaçanikut **z. Besim Ilazi** i cili së pari u dëshiroi mirseardhje përfajqsuesve të rinjë të FSK dhe propozoi këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar
2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut
3. Sfidat e përballjes me pasojat eventuale të kushteve atmosferike dimërore
4. Aprovimi i Planit Vjetor të Punës 2020
5. Të ndryshme

1.Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar

-Proces verbali u miratua nga të gjithë të pranishmit

2.Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut

-Rreth pikës së dytë të rendit të ditës zv.komandanti i policisë tha se situata në përgjithësi gjatë kësaj periudhe 2 mujore ka qenë e qetë dhe stabile.
Aktuale dhe shqetësuese është dukuria e vjedhjeve sidomos në fshatrat Trimor , Nikaj e Dubravë .

Nga një raport 11 mujorë që kemi bërë rezulton se kjo dukuri ka pasur rënje nga vitet e kaluara por që kohëve të fundit ka marrë përmasa të mëdha .
Si stacion i policisë kemi mbajtur takime të ndryshme me banorët e prekur nga kjo dukuri por edhe me institucione të sigurisë .Kemi marrë masa të shtuara duke angazhuar njësitë tona në patrollime sidomos në këto fshatra që u cekën .Gjithashtu kemi vendosur pika kontrolli si dhe kemi intervistuar një numër të madh të personave të dyshuar .
Jemi në prag të festave të fundvitit dhe ne jemi në implementim të planit tonë me qëllim të parandalimit të çdo ekcesi që mundë të ndodhë .Rreth dukurisë së prerjes ilegale të pyjeve ne kemi vendosë një bashkëpunim të mirë me zyrtarët e pylltarisë dhe po mundohemi që ta përmisojmë gjendjen .

Po vazhdohet me aktivitetin „Stop drogave nëpër shkolla” e gjithashtu po e zbatojmë planin operativ ndaj parkingjeve ilegale me moton „Mos parko kudo” .
Kamerat e sigurisë për momentin nuk janë të gjitha funksionale përshkak të punimeve që janë duke u bërë në qytet dhe kjo po na e vështironë punën tonë .
Kryetari: është e vërtetë që dukuria e vjedhjeve më parë ka qenë më e madhe por që janë bërë në kohën e punimeve të autostradës , ndërsa vjedhjet aktuale janë të një natyre tjetër

ngase po ndodhin nëpër shtëpia . Është mirë të vazhdohet me patrollime të shtuara nëpër këto lokalitete dhe sa më shpejtë të kafen kryesit e kësaj vepre . Jemi në përfundim të të punimeve në qytet dhe kamerat e sigurisë do të janë funksionale por që kërkoj që efektet e këtyre kamerave të publikohen .

Kjani Sallahu:Dukuria e vjedhjeve kohëve të fundit është alarmante. A ka të arrestuar në lidhje me këto vepra. Patrollimet e shpeshta të policisë kohëve të fundit si duket e kanë pasur efektin e vet. Rritja e veprave kriminale imponon shtimin e kapaciteteve njerzore të policisë. Kemi kërkuar mbajtjen e një takimi me të gjitha strukturat e sigurisë dhe të drejtësisë në rajonin të Ferizajt: policinë, prokurorin, kryegjykatësin..., pse nuk e ftuat këtë takim?

Kryetari : në takim kam pasur komandantin e policisë –stacioni në Kaçanik dhe nuk e kam parë të arsyeshme të janë prezent Gjykatësi e Prokurori pasi që nuk kemi pasur dëshmi për veprat e kryera .

Jaser Jaha :Në lidhje me vjedhjet që janë kryer kohëve të fundit ne kemi intervistuar shumë të dyshuar duke grumbulluar informata , jemi në procesin e hetimeve dhe ekipi hetues është duke kryer punën e tyre e sa i përket mosprezencën e gjykatësit dhe prokurorit edhe ne e kemi parë të pa arsyeshme të thirren në kët takim ngase nuk kemi pasur ndonjë dëshmi konkrete .

Kjani Sallahu: Dukuria e vjedhjeve në përgjithësi nuk po trajtohet si duhet nga ana e organeve kompetente. Lëndët të shqyrtohen dhe të procedohen sa më shpejtë që është e mundur .

Ramadush Osmani: Kamerat e sigurisë do të funksionalizohen shumë shpejtë por që mendoj që investimin e bërë ta arsyetojmë tek qytetarët . A egziston mundësia që efikasiteti i këtyre kamerave të plasohet në publik . Është një investim që ka bërë komuna dhe ju është dhënë aset stacionit të policisë . Nëse egziston një kod për mirëmbajtje në polici , është mirë që me buxhet të policisë edhe të mirëmbahen .Mendoj se në lidhje me këtë qështje është një paqartësi .

Jaser Jaha:Kamerat e sigurisë kanë shërbyer në ndriqimin e shumë rasteve , ndërsa për publikimin e efikasitetit të kamerave të sigurisë dhe mirëmbajtjen e tyre mbetet të bisedohet në nivelet më të larta . Vlenë të ceket gjithashtu që këto kamera kanë edhe disa probleme teknike që shum shpesh nuk po janë efikase .

3. Sfidat e përballjes me pasojat eventuale të kushteve atmosferike dimërore

-Në pikën e tretë të rendit të ditës , Drejtori i Shërbimeve Publike **Ramadush Osmani** njoftoi se kanë kontraktuar operatorin për mirëmbajtje të rrugëve , i cili operatorështë i përgatitur konform kushteve që i kemi paraparë .Do të punohet sipas plani verorë dhe dimërorë me kontratë 2 vjeqare .

Kryetari:Me kompaninë që kemi kontraktuar mendoj se është bërë një zgjidhje e mirë ngase po e njejta kompani ka shërbyer edhe vitin e kaluar dhe mundë të themi se i ka kryer punët në nivel të kënaqshëm

Kjani Sallahu: Cilat janë kapacitetet e kompanisë si dhe është mirë që në raste kur situatat janë të jashtëzakonshme për shkak të të reshurave të mëdha të borës, njoftohen përfaqësuesit e lokaliteteve me qëllim që të bëhen edhe organizime vullnetare për të sanuar gjendjen.

Ramadush Osmani: Kompania e plotëson kriterin për mirëmbajtje të rrugëve por që në raste të jashtëzakonshme , ne përdorim edhe forma tjera të organizimit për të sanuar gjendjen .

Lulzim Uka:Nëse kompania nuk ka kapacitete të mjafreshme për mirëmbajtje , komuna mundë të kërkoj edhe ndihmën e FSK , e cila ka makineri më të përsosur për të sanuar gjendjen në vendet ku kjo kompani e ka të vështirë të kryejë shërbimin . Mirë është të gjendjen edhe punë vullnetare dhe shpenzimet e derivateve të mbulohen nga Komuna organizohen edhe punë vullnetare dhe shpenzimet e derivateve të mbulohen nga Komuna

Kryetari:Kësot përvoja kemi përdorur edhe në të kaluarën duke bashkpunuar me administratorët e lokaliteteve , FSK dhe me bizneset dhe kët bashkëpunim do ta kemi edhe në të ardhmën . Prioritet do ti ipet rrugëve që janë me rëndësi të cilat lidhin fshatrat me qytet në drejtim të shtëpisë së shëndetit , shkollave dhe gjitha institucioneve që janë në shërbim të qytetarëve .

Jashar Selimi:sa për informatë , kompania ka siguruar mjetet e nevojshme të punës dhe i ka stacionuar në Kaçanik të Vjetër dhe po shpresojmë që shërbimin do ta kryejë si duhet .

4.Aprovimi i Planit Vjetor të Punës 2020

Në pikën e katërt të rendit të ditës rreth planit të punës së KKSBB për vitin 2020,
Ramadush Osmani dha një sugjerim që në takimet e KKSBB nuk ka nevojë të ftohen operatorët ekonomik apo organizatat joqeveritare për të raportuar apo njoftuar në lidhje me shërbimet komunale ,ngase raportimet dhe çdo informacion rreth punëve dhe aktiviteteve publike në komunë mundë ta bëjmë ne si komunë .

Kjani Sallahu: Për operatorët ekonomik ndoshta është e drejtë të mos thirren në takime, por OJQ-të siq është OMM “Gjethi” besoj se mund të marrin pjesë ngase në programin e tyre të punës e kanë mbrojtjen e ambientit, janë shumë aktivë dhe mund të kontribojnë në këtë aspekt.

REKOMANDIMET:

1. Bashkëpunim edhe më i madh i institucioneve të sigurisë dhe komunitetit në luftimin e dukurisë së vjedhjeve dhe çdo dukurie tjeter që cenon sigurinë e qytetarëve
2. Të rriten kapacitetet njerëzore në Stacionin Policor në Kaçanik
3. Prokuroria dhe Gjykata të jetë më ekspeditive në shyrtimin e lëndëve
4. Të monitorohet puna e Kompanisë së përzgjedhur në mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit të dimrit
5. Sa më shpejtë të hyjnë në funksion kamerat e sigurisë të cilat për shkak të punimeve në qytet një pjesë e tyre kanë qenë jashtë funksionit.
6. Të promovohen efektet pozitive kamerave të sigurisë .

Pas këtyre diskutimeve Kryetari mbylli takimin për tu takuar në terminin e radhës që do të mbahet në muajin e dytë të vitit 2020

Kaçanik 24.12.2019



Procesmbajtës:
Fatmir Qaka